



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .12.2022

MBLEDHJA Nr. 64,
Datë 30.12.2022, ora 12:30
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 30.12.2022, ora 12:30**, do të zhvillohet mbledhja nr. 64 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të bordit datë 27.12.2022 dhe datë 28.12.2022
2. Mbi procedurën e nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 21.07.2022, në lidhje me fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k.
3. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 249, datë 13.12.2021, “Mbi rishikimin e vendimit nr. 111, datë 26.04.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 32, datë 04.02.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 84, datë 17.07.2008, i ndryshuar
4. Mbi kërkesën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë “Kroi Mbret” sh.p.k. dhe shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a.
5. Mbi përfundimin e fillimit të procedurës nisur me vendimin e ERE-s nr. 89, datë 28.04.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Hec Bishnica 1, 2” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve, shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. dhe shoqërisë “Hec Bishnica 1, 2” sh.p.k
6. Mbi përfundimin e fillimit të procedurës nisur me vendimin e ERE-s nr. 112, datë 19.05.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Hec-i Tërvolit” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a. dhe shoqërisë “Hec-i Tërvolit” sh.p.k.
7. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI